ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **205-24-4174-5-1-1**

Sa i përket tenderit për **Trajtimi I vendeve te rrezikshme me qellim te ngritjes se nivelit te sigurisë rrugore(Eliminimi I Pikave te Zeza) ne rrjetin rrugor te Rrugëve Nacionale, Rajonale dhe Lidhëse**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**" INTRAST " SH.P.K.**
NUI	**810013269**
Adresa	**Lidhja e Prizrenit 22/1- kat/III/1**
Vendi	**Pristina**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044966669**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Korab Shehu**
Adresa elektronike	**korabshehu@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**04.07.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Trajtimi I vendeve te rrezikshme me qellim te ngritjes se nivelit te sigurisë rrugore(Eliminimi I Pikave te Zeza) ne rrjetin rrugor te Rrugëve Nacionale, Rajonale dhe Lidhëse

Data e njoftimi per kontrate: 26.04.2024

Data e dorezimit: 13.05.2024

Data e vendimit te AK: 11.06.2024

Data e kerkeses per rishtyrtim: 18.06.2024

Data e refuzimit te kerkeses per rishyrtim: 24.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Ne me date 18.06.2024, kemi parashtruar kerkeses per rishqyrtim prane AK. e mjejta kerkese na eshte refuzuar ne pergjithesi pa i kontestuar pikat tona ankimore.

D.m.th. AK nuk ka trajtuar asnje pretendim ankimor.

Qe eshte ne kundrshtim me nenin 108/A te LPP-se dhe nenit 63-64 te rregullore 001/2022 te Lpp-se.

Ne gjithsej i kemi pasur 4 pretendime ankimore, AK nuk e ka shqyrtuar asnjerin.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 108/A i LPP-se - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 66 - Përshtatshmëria Profesionale
Neni 69 - Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 61 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët
Neni 41 - I rregullores - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët
Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës
Neni 11 - Informatat Sekrete Afariste
Neni 7 - I rregullores - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne me date: 11.06.2024 kemi pranuar njoftimin per tenderuesin e pasukseshem per kete aktivitet te prokurimit, me crast e kane shpallur fitues grupi i operatorëve ekonomik:
TSR Sh.p.k.; IDK Konstruksion Sh.p.k.
Ne me date 11.06.2024 kemi kerkuar qasje ne dokumentacionin tenderik te OE ofertues. Qasja na eshte mundesuar me date 14.06.2024, vetem ne oferten e grupit e OE TSR Sh.p.k.; IDK
Konstruksion Sh.p.k. ndersa nuk na eshte mundesuar qasja ne oferten e grupit OE EL-BAU sh.p,k,; Sinjal
sh.p.k.; Avag group sh.p.k. Sinani-ing sh.p.k.me arsyetimin se ky OE e ka klasifikuar te gjithe dosjen si sekret
afarist.

Gjate ekzaminimit te dosjes se OE te rekomanduar per kontrate kemi verejtur se ky OE nuk i ploteson kerkesat teknike dhe administrative te dosjes se tenderit, paramases, njoftimit per kontrate, pasi qe ka ofertuar me cmime jo-normalisht te uleta dhe me

produkte jo-kompatibile
sipas kerkesave te aneksit 1 – Specifikimet teknike te detyrueshme.

Prova 1:
Sipas Neni 61 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët – te LPP-se dhe
Neni 41 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët – te rregullave
OE I rekomanduar per kontrate I ploteson te gjitha kushtet per te iu klasifikuar oferta financiare si tender jonormalisht
i ulet.
Sipas udhezuesit per prokurim publik per tenderet jo-normalisht te ulet: A02 Udhezues Nr-001/2023 per
prokurimin publik?, I ka plotesuar te gjitha kushtet per tu klasifikuar si tender jo-normalisht I ulet.
Me poshte e gjeni te bashkangjitur tabelen e krijuar konform udhezuesit te prokurimit publik.

Nr.	Ofertat - Kalkulimi		
	A	B	C
1	**Kushti 1:** është përmbushur kushti I pare sepse janë pranuar **3** oferta	**Pranuar 3 oferta**	
2	Grup i operatorëve ekonomik: TSR Sh.p.k.; IDK Konstruksion Sh.p.k.	1	**4,324.51€**
3	Grup i operatorëve ekonomik: EL-BAU sh.p,k,; Sinjal sh.p.k.; Avag group sh.p.k. Sinani-ing sh.p.k.	2	**10,432.00€**
4	Grup i operatorëve ekonomik: INTRAST sh.p.k.; SH. Drini Company sh.p.k.; I.T.K. sh.p.k.	3	**21,537.50€**
5		Total:	**36,294.01€**
6		Mesatarja:	**12,098.00€**
7	**Kushti 2:** te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dytë	**pragu 30% (mesatarja /1.3)**	**8,468.60€**
8	**Kushti 3:** pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	**pragu 10% (oferta e dyte /1.1)**	**9,388.80€**

Kushti	Kerkesa	Ar
1	Janë pranuar 3 oferta	Është plotësuar kushti i p
2	Çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson ku i ofruar është me shume tenderëve. Shih
3	Çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët	Oferta e dyte plotëson ec ne krahasim me ofertën e se 10% me i ul
KONKLUDIM	**Oferta me nr. rendor 1, me cmim 4,324.51 € ka ofertuar me lire se 65% ne kr 12,098.00 € dhe si rrjedhoje eshte oferte, jashtezakonish**	

Pra, ky OE ka ofertuar me çmim 65% me te ulte se mesatarja e ofertave.
Dhe ne kete raste AK, konform dispozitave ligjore te lartecekura, ish dashtë ta shpalle OE te papërgjegjshëm, pasi ka ofertuar me çmime jo-normalisht te ulta.
Per me tepër, po te shiqohen edhe pozicionet ne paramasë, pothuajse te gjitha jane me çmime jo-normalisht te ulëta, nje nga nje.
p.sh. Pos. 4.0 SHËRBIMET PËR SINJALIZIMIN VERTIKAL, HORIZONTAL nga 4.15 deri 4.37
Paisjet e sigurisë ne trafik siq jane: VMS, Panelet Ndricuese – Sinjalizuese, Radaret vetëdijësues, LED markeri, Sistemi per detektimin e lartësisë etj. OE ka ofertuar me çmime rreth 90% me te ulëta se çmimet e tregut.

Prova Nr 2:
AK me date: 08.05.2024 ka publikuar sqarimin e tenderit duke ju përgjigjur ne pyetjet e parashtruara si me poshtë.
Pyetja: Çertifikatat EN, ISO ,Autorizimet e Prodhuesit , Katalogjet, Raportet e testimi dhe dokumentet
garantuese te prodhuesit te kërkuara ne dosje te tenderit , Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TE
DETYRUESHME dhe ne paramase a duhet te dorëzohet me rastin e ofertimit?

Përgjigjja: Ju lutem referojuni Dosjes se Tenderit dhe FDT. Te gjitha dokumentet e prezantuara ne
6/3dosje te tenderit duhet te ofertohen.

Me kete rast AK ka konfirmuar se OE duhet te dorëzojnë te gjitha certifikatat, autorizimet

qe kërkohen ne dosjen e tenderit, specifikim teknik, me paramasë etj.

Ne, Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME, jane kërkuar:

Për te gjitha produktet pjese e specifikimit teknik duhet te prezantohet autorizimi nga
prodhuesi me dokumentacionin e garantues.

Certifikate: EN 12352 – te dorëzohet me oferte.
Certifikate : EN 12352, EN50293, EN60529, 2011/65/UE, 2014/30/UE –
te dorezohet me oferte.
Certifikimi: Sipas standardit EN 12966-1:2005 A1:2009
Certifikimi: Sipas standardit EN 12966-1:2005 A1:2009

OE i rekomanduar per kontrate nuk ka dorëzuar asnjë nga certifikatat dhe garancionet te kërkuara sipas dosjes se tenderit, dhe aneksit 1 te specifikacioneve teknike te detyrueshme.

Prova Nr 3:
AK, NUK na ka lejuar qasje ne dokumentacionin e OE Grup i operatorëve ekonomik: EL-BAU sh.p,k,; Sinjal sh.p.k.; Avag group sh.p.k. Sinani-ing sh.p.k., ne asnje document te tij, me arsyetimin se ka nenshkruar deklaraten e sekretit afarist.

Kjo eshte ne kundershtim me Neni 10 - Mjetet për promovimin e Transparencës dhe Neni 11 -
Informatat Sekrete Afariste te LPP-se dhe Neni 7 - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion
te rregullave per prokurim publik.

Ne nenin 10.par.3. te LPP-se shkruan qarte se:

Me kërkesën me shkrim nga cilado palë e interesit, autoriteti kontraktues i siguron qasje të arsyeshme palës qëarte kërkon të ketë qasje në të dhënat e përshkruara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, përveç informatave sekrete afariste të cilat vërtetohen si të tilla nga një autoritet përkatës që kanë të bëjnë me çfarëdo aktiviteti të prokurimit që është mbyllur. Për qëllime të paragrafit 3. të këtij neni, aktiviteti i prokurimit konsiderohet i mbyllur (i) në datën e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit, (ii) në datën e dhënies së kontratës në rast të tenderëve sipas nenit 37 të këtij ligji, ose (iii) nëse aktiviteti i prokurimit formalisht është anuluar ose përndryshe është përfunduar para dhënies ose zgjedhjes së fituesit, atëherë në datën e njoftimit për anulim sipas paragrafit 2. të nenit 62 të këtij ligji ose në datën kur aktivitete ishin përmbyllur.

Ndersa, sipas nenit 7 par.5 i rregullave, shkruan qarte se cilat dokumente mund te klasifikohen si sekrete afariste:

7.5 Informacionet të cilat mund të klasifikohen si informacione sekrete afariste janë:
a. informacionet në lidhje me pasqyrat ekonomike dhe financiare, neni 68 i LPP-se; dhe
b. informacionet në lidhje me mundësitë teknike dhe/ose profesionale, neni 69 i LPP-se.

Pra, dokumentet qe jane publike si: kontratat me autoritete publike, referencat, makineritë, lista e punetorve, paramasa dhe parallogaria, pjesa C e dorëzimit te tenderit nuk jane dokumente qe perbejne sekrete afariste.

AK me kete rast, ka bere shkelje flagrante te neneve te lartpërmendura duke mos na lejuar qasje ne asnjë dokument te vetëm te OE EL-BAU sh.p,k,; Sinjal sh.p.k.; Avag group sh.p.k. Sinani-ing sh.p.k.

AK me rastin e vleresimit te ketij aktiviteti te prokurimit, ka bere shkelje flagrante:

Te nenit 108/A te Lpp-se. duke mos u pergjigjur apo arsyetaur asnje pretendim ankimor te ankeses tone.

te nenit 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi te LPP-se duke mos e vlerësuar gjendjen faktike
dhe materiale te te gjithë OE ne menyre te barabarte.

Te nenit 66 – Pershtatshmeria profesionale te LPP-se, duke e rekomanduar per kontrate nje OE qe nuk i
plotëson kriteret minimale teknike dhe administrative te dosjes se tenderit.

Te nenit 69 – Aftesia teknike dhe/ose profesionale te LPP-se, duke e rekomanduar per kontrate nje OE qe
nuk e ka dorëzuar dokumentacionin teknik sipas kërkesave te dosjes se tenderit.

Te nenit 61 te LPP-se, Nenit 41 te rregullave – Tenderet jo-normalisht te ulet, duke rekomanduar per kontrate
nje OE qe ka ofruar çmim 65% me te ulte se mesatarja e ofertave.

Te nenit 10 – Mjetet per promovimin e transparencës te LPP-se

Te nenit 11– Informatat Sekrete-Afariste te LPP-se

Te nenit 7 - Informata Sekrete afariste dhe Qasja në Dokumentacion te rregullave, duke mos na lejuar
qasje ne asnjë dokument te OE EL-BAU sh.p,k,; Sinjal sh.p.k.; Avag group sh.p.k. Sinaniing
sh.p.k.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Tani per tani te papercaktuara

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*